

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME MIRËDITË SHA

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në SHA Ujësjellës Kanalizime, Mirditë, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën 01.01.2012 deri 31.10.2012, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 168 datë 15.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 693/6 datë 15.12.2014, dërguar Z. Marie Doda, Drejtore e Ujësjellës Kanalizime SHA Mirditë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Në ekstraktin historik të regjistrimit tregtar QKR nuk janë bërë azhurnimet nga viti 2007 për ndryshimet e mëvonshme deri në momentin aktual, në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët e shoqëritë tregtare”, neni 106 “regjistrimi”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa, nga Drejtoria e shoqërisë SHA “Ujësjellës Kanalizime” Mirditë, që të bëhen të gjitha azhurnimet përkatëse të vendimeve për ndryshime të Shoqërisë dhe për ndryshimin e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, pranë QKR Rrëshen.

Deri me 31.12.2014

2. Drejtori i Shoqërisë nuk ka hartuar një rregullore të brendshme, të cilën duhej ta paraqiste për miratim në këshillin mbikëqyrës, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët e shoqëritë tregtare” neni 158, pika 3, neni 163, pika 1/a, dhe Statutin e Shoqërisë të miratuar nga METE, neni 12, pika 6.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Shoqërisë të merren masa, për hartimin e rregullores së funksionimit të brendshëm, duke implementuar në të kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Deri me 31 .01. 2015

3. Në programet financiare afatmesme nuk janë përfshirë plani strategjik i zhvillimit, nuk është përcaktuar misioni, matrica e qëllimeve strategjike, objektivat, fushat prioritare dhe projektet. Në programet vjetore ekonomike-financiare, planifikimi treguesve e prodhimit, faturimit dhe arkëtimit është bërë i pastudiuar dhe nuk ka saktësi. Në relacionet dhe në raportet mbi realizimin e programit ekonomik të Sektorit Ekonomik, nuk jepen shpjegime të sakta mbi arsyet dhe faktorët e realizimit ose mosrealizimit të treguesve të planifikuar.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Drejtoria e shoqërisë, për ngritjen e një grupi pune që të kryejë hartimin e programit zhvillimit ekonomik të shoqërisë afatmesëm dhe atij vjetor të mirë studiuar në planifikimin e treguesve, i cili të bazohet mbi një plan strategjik të zhvillimit, ku të jenë përcaktuar objektiva të qarta, fushat prioritare, projektet, i detajuar në programe mujore si dhe të ndjekë e të monitorojë realizimin e tij, duke bërë analizën faktoriale dhe rekomandimin e masave për përmirësimin e gjendjes.

Vazhdimisht

4. Programimi i të ardhurave është bërë mbi bazën e numrit të abonentëve që kanë pritshmëri arkëtimi dhe jo mbi bazën e të gjithë abonentëve që janë të identifikuar, prandaj dhe arkëtimi ka rezultuar me tejkalim. Shoqëria ka shpenzuar për të prodhuar ujë, por mesatarisht rreth 48 % e sasisë ujit humbet përveç humbjeve teknike në masën 23% që njihen ligjërisht nga uji i prodhuar, shpërdorohet në rrjetin e ujës-jellësve, të cilat janë llogaritur si humbje tekniko-ekonomike dhe njihen si të tilla, duke e bërë shoqërinë jo rentabël me një performancë jo të mire. Në lidhje me treguesin e koeficientit të humbjeve e cila arrin rreth 71 %, nga ana e drejtorisë së shoqërisë, nuk ishte kryer asnjë programim dhe asnjë analizë për këtë tregues shumë të rëndësishëm për rezultatet e shoqërisë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa, nga Drejtoria e shoqërisë, për përmirësimin e performancës për treguesit prodhim-faturim, faturim-arkëtim dhe të uljes së humbjeve në rrjet, me qëllim përmirësimin e situatës financiare të shoqërisë.

Vazhdimisht

5. Humbjet rezultojnë nga gjendja teknike e rrjetit të shpërndarjes, pasi është tejet i amortizuar dhe i pa rikonstruktuar, si dhe ka një numër shumë të madh lidhjesh të paligjshme të bëra në zonën e fshatit dhe zonën informale të qytetit, për të cilat nuk është ndërmarrë asnjë veprim për evidentimin dhe ligjërimin e tyre ose penalizimin e tyre si kundravajtje administrative, në kundërshtim me VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë”, i ndryshuar, pika 5 dhe Udhëzimit nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, pika V, nënpika 6.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e shoqërisë, të merren masa duke ngritur grup pune të përbashkët me Bashkinë Rrëshen, Komunën Selitë dhe Komunën Orosh, të evidentohen rastet e lidhjeve të pa ligjshme për ujin e pijshëm, në zonën e fshatit dhe zonën informale të qytetit, duke zbatuar penalitetet ligjore në fuqi.

Deri me 28 Shkurt 2015

6. Humbjet rezultojnë dhe nga faturimi afrofe për 847 subjekteve nga 1264 subjekte që faturohen ose rreth 67%, pasi nga ana e shoqërisë nuk janë programuar dhe kryer investime në drejtim të vendosjes së matëseve të ujit, për shkak të gjendjes së vështirë financiare. Në vitin 2011 janë vendosur 879 copë matësa, por ato janë dëmtuar nga vetë abonentët dhe kanë mbetur vetëm 410 matësa ekzistues në kundërshtim me VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë”, i ndryshuar, pika 2 si dhe Udhëzimit nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, pika II, vendosja.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e shoqërisë, të merren masa duke ngritur grup pune të përbashkët me Bashkinë Rrëshen, Komunën Selitë dhe Komunën Orosh, për ndjekjen e hapave ligjorë për evidentimin e të gjithë abonentëve, që furnizohen me ujë dhe faturohen afrofe, për pajisjen e tyre me matës, duke ulur në këtë mënyrë numrin e abonentëve me faturim afrofe.

Deri me 30 Prill 2015

7. Humbjet kanë ndodhur edhe nga mos lidhja e kontratave (mos faturimi), nga mungesa e të dhënave të sakta si rezultat i mosbashkëpunimit me institucionet e tjera për numrin e familjeve dhe numrin e bizneseve, që kanë lidhur ose nuk kanë lidhur kontratë me këtë shoqëri, gjë e cila nuk ka bërë të mundur gjykimin e drejtë në drejtim të humbjeve në rrjet si pasojë e konsumit të ujit nga familjarë e biznese pa kontratë dhe ligjërimin e tyre në kundërshtim me VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë”, i ndryshuar, pika 1.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa, nga Drejtoria e Shoqërisë, për identifikim e abonentëve familjarë, të subjekteve privatë dhe institucioneve, duke përcaktuar zonën sipas vendndodhjes e tyre dhe të ndiqen hapat ligjore për të lidhur kontratat e furnizimit me ujë. Të ngrihet grup pune i përbashkët me Bashkinë Rrëshen dhe Komunën Selitë dhe Komunën Orosh për azhurnimin e të dhënave për numrin e familjeve dhe bizneseve që kanë lidhur kontratë me këtë shoqëri, me numrin e familjeve në Zyrat e Gjendjes Civile të këtyre njësisve vendore, numrin e familjeve që kanë lidhur kontratë me CEZ Shpërndarje në Rrëshen, si dhe numrin e subjekteve private në Drejtorinë e Tatim Taksave Rrëshen.

Deri me 31 Mars 2015

8. Në Shoqërinë SHA Ujësjiellës-Kanalizime Mirditë, nga stafi drejtues nuk ka njohje të komponentëve të MFK, të ligjit të MFK dhe koncepteve të tij. Si rezultat nuk janë hartuar plani për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar, nuk është përcaktuar një strategji, nuk janë përcaktuar objektivat, si dhe nuk janë hartuar plan-veprimet afatshkurtra për implementimin e Ligjit nr. 10.296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” në zbatim të tij.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Shoqëria për njohjen nga menaxheri dhe stafi drejtues i ligjit të MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin e një plan-veprimi, ku të jenë përfshirë hapat që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të MFK-së, përfshirë menaxhimin e riskut në një linjë me hartimin e programit ekonomik. Në planet konkrete të veprimit të përcaktohen misioni, strategjia dhe objektivat, të cilat duhet të përmbajnë afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre.

Deri me 31 Janar 2015

9. Gjendja e debitorëve gjithsej e trashëguar në vite deri në 31.12.2013 janë në vlerën 89,002,625 lekë. Me pritshmëri arkëtimi vlera prej 23,619,176 lekë, ku nga këta abonentë familjarë në vlerën 15,018,320 lekë, abonentë shtetërorë në vlerën 7,661,676 lekë dhe abonentë privatë në vlerën 939,180 lekë. Pa shpresë arkëtimi vlera prej 65,383,449 lekë, ku nga këta abonentë familjarë në vlerën 59,289,164 lekë, abonentë shtetërorë në vlerën 2,097,407 lekë dhe abonentë privatë në vlerën 3,996,878 lekë. Situata e mësipërme tregon për një punë jo të mire nga administrata e SHA Ujësjiellës Kanalizime Mirditë në drejtim të arkëtimit të të ardhurave nga uji i pijshëm në kundërshtim me VKM nr. 236 datë 10.5.1993 “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë”, i ndryshuar me VKM nr. 96, datë 21.2.2007.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Shoqëria, për ngritjen e një grupi pune, që të bëjë rakordimin dhe saktësimin në analizë të veçantë të gjithë debitorëve sipas viteve, sa abonentë nuk paguajnë dhe arsyet e mos pagesës, të shikohet mundësia e informatizimit dhe hedhjes graduale të tyre në sistem elektronik. T'u dërgohen subjekteve debitorë njoftim-detyrimet për shumat përkatëse, të ndiqen me qëllim arkëtimin e tyre, dhe në rastet e mos pagesave të zbatohen sanksionet ligjore ndaj subjekteve, të cilët nuk shlyejnë detyrimet, deri në bllokim të furnizimit me ujë etj.

Deri me datë 28.02.2015

10. Mos derdhja e detyrimeve, që ka shoqëria ndaj buxhetit të shtetit deri në datën 30.05.2014 për sigurimet shoqërore e shëndetësore të akumuluar nga viti 2011-2014 në shumën 6,433,621 lekë, është në kundërshtim me ligjin nr. 9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 700, datë 18.06.2009 në zbatim të ligjit 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, neni 6 dhe neni 114, i cili përveç detyrimit të pa likuiduar penalizon subjektin me gjobë në masën 5% të vlerë së detyrimit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga ana e Shoqërisë, të shqyrtohet detyrimi ndaj buxhetit të shtetit në shumën 6,433,621 lekë, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, duke u nisur nga aftësia paguese e Drejtorisë dhe të shikohet mundësia e likuidimit gradual të këtij detyrimi brenda afateve kohore sa më të shkurtra, që do të përcaktohen, pasi ky përbën detyrim ligjor edhe ndaj punonjësve që kanë derdhur kontribute dhe nuk janë të siguruar për një periudhë 3-vjeçare.

Menjëherë

11. Mos derdhja e detyrimeve, që ka shoqëria ndaj buxhetit të shtetit deri në datën 30.05.2014 për tatimin mbi të ardhurat të akumuluar nga viti 2011-2014 në shumën 2,829,473 lekë është në kundërshtim me Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar neni 6 dhe 114, i cili parashikon penalizim me gjobë në masën 5% të shumës.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga ana e Shoqërisë të shqyrtohet detyrimi ndaj buxhetit të shtetit në shumën 2,829,473 lekë për tatimin mbi të ardhurat, duke u nisur nga aftësia paguese e Drejtorisë, dhe të shikohet mundësia e likuidimit gradual të këtij detyrimi brenda afateve kohore sa më të shkurtra, që do të përcaktohen.

Menjëherë

12. Mos deklarimi dhe mos derdhja e TVSH në vlerën 2,459,086 lekë pranë organeve tatimore, detyrim që ka shoqëria ndaj buxhetit të shtetit deri me datë 31.05.2014 është në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 114.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga ana e Shoqërisë të shqyrtohet detyrimi ndaj buxhetit të shtetit në shumën 2,459,086 lekë për TVSH, duke u nisur nga aftësia paguese e Drejtorisë, dhe të shikohet mundësia e

likuidimit gradual të këtij detyrimi, brenda afateve kohore sa më të shkurtra, që do të përcaktohen.

Menjëherë

13. Për të tre vitet mungon regjistri i parashikimit dhe i realizimit të dërguar në APP për prokurimet me vlerë të vogël në bazë të nevojave për mallra dhe shërbime në kundërshtim me pikën 3/b të Kreut I dhe pikës 2/a Kreu i VI në VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar dhe Udhëzimi i APP nr. 28, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” pika 1,4.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Shoqëria, që në bazë të nevojave për mallra dhe shërbime të hartohet regjistri i parashikimit dhe realizimit të prokurimeve dhe të paraqiten pranë Agjencisë së Prokurimit Publik.

Vazhdimisht

14. Nga auditimi i procedurave të blerjeve me vlera të vogla u konstatuan shkelje të procedurave të prokurimit në 42 raste në vlerën 5,459,172 lekë në kundërshtim me Kreun e VI në VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar VKM nr. 47 datë 23.01.2013 “Për një shtesë në VKM nr. 45 datë 21.01.2009 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike” dhe Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 28 datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” pika 5 e tij i ndryshuar me Udhëzimin e APP nr. 5 datë 16.07.2013 dhe Udhëzimin e APP nr. 1 datë 28.02.2014. Po kështu, **këto procedura janë në kundërshtim** me UMF nr. 92 datë 29.12.2011 “ Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë ” tabela 1/3 dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “ Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 10 dhe Kapitulli “Dokumentimi lëvizjes së aktiveve”pika 35/b dhe 36.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Drejtoria e SHA UK Mirditë, për hartimin e gjurmës standarde të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, ku të përcaktohet procesi i punës që nga hartimi i kërkesave deri në përfundimin e procedurës së prokurimit, duke vendosur strukturat zbatuese dhe të miratohet nga titullari.

Deri 15.01.2015

15. Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Furnizimi me ujë i zonave rurale Rrëshen, rrjeti shpërndarës, faza II*” bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë fitues të tenderit ■■■■■shpk nuk duhej të kualifikohej dhe tenderi duhej të anulohet ,pavarësisht se kishte vlerën më të vogël të ofertës, pasi në dokumentacionin e paraqitur kishte parregullsi si:

-Nuk janë plotësuar kërkesat e Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST) nga të gjithë operatorët të Bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë në lidhje me xhiron mesatare vjetore gjatë tre viteve të fundit, licencën profesionale të Shoqërisë për ekzekutimin e punëve të kontratës, punësimin mesatar të paktën prej 40 personash për tre vitet e fundit në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007”, Kreu VII , “Kushte të përgjithshme për zbatim”, pika 2, ”Bashkimi i operatorëve ekonomikë” , pika ”c”, ku kërkohet “ Çdo operator ekonomik duhet të

përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

-Në lidhje me kontratën e bashkëpunimit rezulton se, nuk është firmosur nga të tre operatorët por vetëm nga dy prej tyre dhe në ofertë apo në marrëveshjen prokurë nuk janë përcaktuar punët konkrete për secilin operator të grupit në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 Kreu VII, “Kushte të përgjithshme për zbatim”, pika 2, germa ”b. Amendamenti shtesë kontrate është lidhur pa përfunduar kontrata bazë si dhe mungon argumentimi teknik i saj, në kundërshtim me nenin 4 “Afati për kryerjen e punimeve” nënpika 4.2.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Ujësllës Kanalizime, Mirditë me cilësinë e Autoritetit Kontraktor në ato raste kur, konstaton mangësi në plotësimin e dokumenteve standarde të operatoreve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, në zbatim të nenit 45 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” dhe pikës 2, Kreu VII të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet tu kërkojë operatorëve ekonomik sqarime për këto mangësi, për të shqyrtuar dhe krahasuar ofertat e tyre sa më drejtë në raport me ofertat e tjera.

Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga Administratori i Shoqërisë “UKT” sh.a (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim evidentimin dhe njohjen e shpërblim dëmit në vlerën **4,279,674 lekë**.

1. Është kryer shpenzimi në shumën **58,500 lekë** për dhënien e shpërblimit Përgjegjëses së Sektorit Ekonomik zj [REDAKTUAR] me motivacionin “për punë të mirë” me burim financimi fondin e veçantë referuar në mënyrë të gabuar VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” i cili vlen vetëm për institucionet buxhetore. Për shoqëritë anonime dhënia e shpërblimeve të punonjësve është kompetencë e këshillit mbikëqyrës dhe rregullohet me ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 ”Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”. Nisur nga fakti se shoqëria rezulton me humbje, shpërblimi i dhënë është në kundërshtim me nenin 6, pika 1 dhe 2, të këtij ligji.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Shoqëria që të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës 58,500 lekë të përfutur padrejtësisht nga zj [REDAKTUAR]

Menjëherë

2. Janë kryer pagesa në vlerën **3,521,160 lekë** të operatorit ekonomik “[REDAKTUAR]” sh.p.k, Tiranë, për diferenca të konstatuara në volumet e punimeve të kryera në lidhje me zbatimin e kontratës me objekt “Furnizimi me ujë i zonave rurale Rrëshen, rrjeti shpërndarës, faza II” në

kundërshtim me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga SHA Ujësjetës Kanalizime Mirditë të kërkohen në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 3,521,160 lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për Operatorin Ekonomik “██████” sh.p.k, Tiranë, vlerë të cilën e ka përfituar për punime të pakryera në tenderin me objekt “Furnizimi me ujë i zonave rurale Rrëshen, rrjeti shpërndarës, faza II”

Menjëherë

3. Në 34 raste në vlerën 292,000 lekë janë bërë pagesa referuar vendimit të pa saktë të Këshillit Mbikëqyrës nr. 2, datë 10.02.2010, për udhëtim e dieta me tarifën prej 2,500 lekë të një dite të plotë ose tarifën prej 1,000 lekë për gjysmë dite për largësi nën 100 km në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit pika 3.1 dhe 3.2.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Shoqërisë të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 292,000 lekë, të përfituar padrejtësisht nga punonjësit për shpenzime udhëtim e dieta, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

4. Janë kryer shpenzime **në vlerën 150,000 lekë** për karta telefoni celular për Drejtorin e Shoqërisë z. ██████ në kundërshtim me VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë” pika 9, ndërkohë që Drejtori e ka pagën nën nivelin II-b të pagave të funksionarëve në pushtetin qendror, të klasifikuar në këtë dispozitë ligjore.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Shoqërisë të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 150,000 lekë, të përfituar padrejtësisht për shpenzime për karta telefoni celular nga z. ██████ duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

5. Janë kryer pagesa në 50 raste në shumën 580,138 lekë për shërbime personave fizik në mungesë të faturës tatimore dhe nuk është mbajtur tatimi në burim i tatimit mbi të ardhurat në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Tatimi mbi të ardhurat” kreu IV, neni 33, pika 1, me pasojë dëmin ekonomik në shumën **58,014 lekë** (580,138 lekë x 10% tatim).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Sh.A Ujësjetës kanalizime Mirditë të kërkohen në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 58,014 lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, nga personat fizik ██████ në shumën 20,870 lekë, z. ██████ në vlerën 5,654 lekë, z. ██████ në shumën 30,000 lekë, SHA UK ██████ në shumën 1,490 lekë, të cilëve nuk u është ndaluar tatimi në burim, për shërbimet e kryera në mungesë të faturave tatimore.

Menjëherë

6. Janë kryer pagesa në shumën në vlerën 200,000 lekë personit fizik [REDAKTUAR] për vitin 2012 në 13 raste në shumën 106,000 lekë, për vitin 2013 në 9 raste në shumën 77,000 lekë dhe në 6-mujorin e pare të vitit 2014 në 3 raste në shumën 17,000 lekë për shpenzime transporti të pajustificuara me dokumente autorizues, vërtetues dhe verifikues, në kundërshtim me VKM nr 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël ” kapitulli I, pika 1/c, me VKM nr 1 datë 10.01.2007 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili në kreun VI pika 2/c “Prokurimi me vlera të vogla”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 12 pika (dh),(e),(f), me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik ” pika 10 dhe Kapitulli “Dokumentimi lëvizjes së aktiveve” pika 34,35/a,b.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga SHA Ujësjetllës kanalizime Mirditë të kërkohen në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 200,000 lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, nga individi [REDAKTUAR] përfituar padrejtësisht për shërbime transporti në mungesë faturave dhe dokumenteve justifikues

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin nr. 37, të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, me ndryshimet e mëvonshme, si dhe kontratës individuale neni 9, kërkohet nga Drejtori i SHA Ujësjetllës Kanalizime, Mirditë të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

I. “Vërejtje”, për:

- 1. [REDAKTUAR] me detyrë hidraulik në sektorin teknik, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla. (Trajtuar në proces verbalin , me nr. 1, datë 26.9.2014 të protokolluar me nr. 174, datë 30.09.2014)***
- 2. [REDAKTUAR] me detyrë specialist në sektorin e pompave, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me blera të bogla. (Trajtuar në proces verbalin , me nr. 1, datë 26.9.2014 të protokolluar me nr. 174, datë 30.09.2014)***
- 3. [REDAKTUAR] me detyrë përgjegjëse e programit të faturimit, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla.***

Punonjësit e lartpërmendur në procedurat e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla kanë vepruar në kundërshtim me Kreun e VI në VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar VKM nr. 47 datë 23.01.2013 “Për një shtesë në VKM nr. 45 datë 21.01.2009 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike” dhe Udhëzimi i APP nr. 28 datë 18.02.2008 “ Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” pika 5 e tij i ndryshuar me Udhëzimin e APP nr. 5, datë 16.07.2013 dhe Udhëzimin e APP nr. 1, datë 28.02. 2014, me UMF nr. 92, datë 29.12.2011 “ Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë ” tabela 1/3 dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “ Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 10 dhe Kapitulli “Dokumentimi lëvizjes së aktiveve” pika 35/b dhe 36. (Trajtuar në proces verbalin , me nr. 1,

datë 26.9.2014 të protokolluar me nr. 174, datë 30.09.2014 dhe në faqen 51-52, dhe 54-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4. ■■■■■ me detyrë arkëtare,

-për pagesën për shërbime transporti në mungesë faturave dhe dokumenteve justifikues.

-për mbajtje gjendje mujore në arkë për shuma të konsiderueshme pa u derdhur në bankë, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli “Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlere” pika 61 dhe 64. (Trajtuar në proces verbalin , me nr. 1, datë 26.9.2014 të protokolluar me nr. 174, datë 30.09.2014 dhe në faqen 53-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5. ■■■■■ me detyrë përgjegjëse e sektorit teknik, për mos menaxhim të procesit të prodhimit të ujit deri tek konsumatori. (Trajtuar në akt verifikimin nr. 5, datë 25.09.2014 të protokolluar me nr. 172, datë 30.09.2014 dhe në faqen 27-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

II. Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e Auditimit janë konstatuar përgjegjësi të natyrës administrative, drejtuese, menaxhuese, ligjzbatuese, të cilët mund të vlerësohen me masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim largim nga detyra”, në varësi të përgjegjësisë së konstatuar për:

1. ■■■■■ me detyrë Drejtor i Shoqërisë SHA Ujësjellës Kanalizime Mirditë, për periudhën 01.01.2012 deri 11.09.2014. (Trajtuar në procesverbalin , me nr. 1, 2, 3 të prot, me nr. 174, 175, 176, me datë 30.09.2014)

2. ■■■■■ me detyrë Përgjegjëse e sektorit ekonomik për periudhën 01.01.2012 deri 30.09.2014. (Trajtuar në procesverbalin , me nr. 1, 2, 3, të protokolluara me nr. 174, 175, 176, me datë 30.09.2014)

3. ■■■■■ në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. (Trajtuar në procesverbalin , me nr. 2, datë 29.9.2014 protokolluar me 176, me datë 30.09.2014)

4. ■■■■■ në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. (Trajtuar në procesverbalin , me nr. 2, datë 29.9.2014 protokolluar me 176, me datë 30.09.2014)

Meqenëse personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune, masën e propozuar e konsiderojmë të ezauruar.

Grupi i Auditimit

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Skënder Muça, Irma Shkupi, Kujtim Rama, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standarteve Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Sekretari i Përgjithshëm Luljeta Nano.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT